



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-klina.org

KOMUNA KLINË
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

Nr.No.Br.

052-499661

RAPORT VJETOR

Data-Date-Datum

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Klinë-Klina

PËR VITIN 2019

Parimi kryesorë i KKSBB-së gjatë kësaj periudhe raportuese ka qenë kryesisht i përqendruar në aktivitete për çështje të sigurisë në bashkëpunim me policinë dhe qytetaret, si dhe me forumet, organizatat tjera të sigurisë, KLSP-të, dhe përfaqësues të shoqërisë civile, për të identifikuar dhe shqyrtuar çështjet që lidhen me problemet e sigurisë në bashkësi, me synim të zgjidhjes konkrete të këtyre problemeve.

KKSBB-ja ka pasur si synim identifikimin e dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike, parandalimin e veprimeve të cilat kërcënojnë sigurinë në bashkësi, eliminimin e dukurive që lidhen me natyrën e krimit, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme, si dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me të gjitha komunitetet që jetojnë në territorin e komunës së Klinës.

Në takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, gjatë vitit 2019

janë trajtuar këto çështje:

Shqyrtimi dhe miratimi i planit të veprimtë të KKSBB-së për vitin 2019, dinamika e punës për vitin 2019, miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura, çështjet e sigurisë në komunën e Klinës, çështjet e arsimit në institucionet shkollore dhe parashkollore, pajisjet me kamera aty ku ka qenë e nevojshme në shkolla dhe rrugë, mbrojtja dhe rreziku nga zjarr vënie, ndriçimi në hapësirat publike, qentë endacakë, masat parandaluese për përdorimin e mjeteve piroteknike gjatë festave të fund vitit etj...

Takimet e KKSBB-ë janë kryesuar nga nënkryetari i komunës së Klinës z. Besim Hoti, i cili pas propozimit të rendit të ditës, është marrë me vërejtjet, sugjerimet, kërkesat dhe ankesat e të gjithë anëtarëve të KKSBB-së si dhe zgjedhjen e tyre në bashkëpunim me drejtoret e drejtorive përkatëse.

Komandanti i policisë ka raportuar në çdo takim për gjendjen e sigurisë në territorin e komunës së Klinës. Bashkëpunimi i policisë me komunën, anëtarët e KKSBB-së si dhe qytetarë ka qenë në

nivel shumë të lartë. Përfaqësuesit e bashkësive fetare, kanë qenë falënderues sa i përket sigurisë nga ana e policisë së Kosovës, si dhe nga ana e komunës së Klinës, për bashkëpunim dhe zgjidhjen e kërkesave të parashtruara. Ka pasur diskutime të ndryshme nga të gjithë anëtarët e KKSB-së, FSK-së, përfaqësues nga këshilli i prindërve, dhe OJQ-ve për probleme të ndryshme, si dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Klinës.

Në takime kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga OSB-ja, KFOR-i, FSK-ja

Të gjitha diskutimet, vërejtjet, sugjerimet dhe kërkesat e parashtruara nga pjesëmarrësit e KKSB-së, janë diskutuar, shqyrtuar nga përfaqësues kompetent të organeve komunale.

Rezultatet e arritura nga takimet e KKSB-së për vitin raportues 2019

-Institucionet komunale janë marrë më shumë me ndriçimin, në disa pjesë të qytetit janë ndërmarr masa nga drejtoria përkatëse për rregullimin e ndriçimit.

-Heqjen e disa shenjave të komunikacionit aty ku kanë qenë vendosura gabim, vendosjen e shenjave adekuate.

-Masa të ndërmarra nga policia e Kosovës dhe Inspektoret, ndaj të gjithë atyre të cilët kanë rrezikuar sigurinë publike me zjarr vëniet.

-Policia e Kosovës së bashku me institucionet komunale, janë angazhuar për bashkatdhetarët të cilët janë kthyer për pushime në vendlindje, që të shërbejnë me lehtë dhe me shpejt me shërbime komunale, sigurinë etj.

-Shtimi i kamerave në disa shkolla dhe disa pjesë të qytetit.

-Marrja e masave të duhura parandaluese për përdorimin e mjeteve piroteknike gjatë festave të fund vitit

Gjatë vitit 2019 janë mbajtur të gjitha takimet e rregullta të KKSB-së, të gjitha materialet për mbajtjen e takimeve u janë dorëzuar me kohë anëtareve dhe pjesëmarrësve të cilët kanë qenë të ftuar në takime.

Procesmbajtësi

Ahmet Berisha



Kryetari

Zenun Elezaj

